

Demokrasi Plus (D+) ka monitoruar publikimin e kontratave për pesë komuna: Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Kamenicë dhe Podujevë. Janë monitoruar të gjitha kontratat e nënshkruara nga 1 janar deri më 31 tetor 2019.

Gjetjet e D+ tregojnë se në përgjithësi niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim është i kënaqshëm. Komuna e Kamenicës dhe Fushë Kosovës kanë përqindjen më të lartë të publikimit me 93%, përkatësisht 95%. Komuna e Shtimes qëndron pak më keq me 85%. Në anën tjetër, komuna e Obiliqit ka pak më shumë se gjysmën e kontratave të publikuara 55%, ndërsa komuna e Podujevës për shkak të numrit të madh të kontratave të publikuara pa listë të çmimeve, gjithsej 65 kontrata, e ka nivelin shumë të ulët të publikimit me vetëm rreth 20%.

Sa i përket publikimit në ueb faqe, kur dihet se nuk është i obliguar me ligj, transparenca është më e ulët. Komuna e Fushë Kosovës dhe Obiliqit kanë ndryshuar datat e publikimit, duke manipuluar me të dhëna, prandaj një gjë e tillë nuk mund të të konsiderohet si transparençë. Komuna e Shtimes qëndron pak më dobët me 21% të kontratave të publikuara, por në ueb faqe i publikon shpejtë, kryesisht në ditën e nënshkrimit. Ndërsa, komuna e Podujevës edhe në ueb faqe shumicën e kontratave i ka pa listë të çmimeve, të cilat nuk janë llogaritur si kontratë e publikuar, e si pasojë niveli i publikimit është shumë i ulët, 15%.

Kontratat e pa publikuara, ato që janë të publikuara më shumë vonesë, si dhe ndryshimet e datave të publikimit në dy komuna mund t'ju atribuohen mungesës së komunikimit mes zyrës së prokurimit dhe zyrës së teknologjisë informative. Mirëpo, publikimi në e-Prokurim është përgjegjësi e zyrës së prokurimit pasi kjo zyrë publikon të gjitha dokumentet tjera në platformë.

Disa nga rekomandimet e D+ janë:

- Të gjitha komunat duhet të sigurohen që të publikojnë të gjitha kontratat në e-Prokurim dhe në ueb faqe brenda dy ditëve nga nënshkrimi; t'i kushtojnë më shumë rëndësi publikimit në ueb faqe, në mënyrë që mos të ketë dallime në mes të këtyre dy platformave;
- Komuna e Shtimes dhe Obiliqit duhet që t'i emërtojnë kontratat në ueb faqe me emrin e aktivitetit të prokurimit. Në e-Prokurim mund të kërkohet me emër të tenderit dhe elemente tjera, por në ueb faqe nevojitet emri i saktë në mënyrë që të mund të kërkohet;
- Komuna e Podujevës duhet që të përfshijë në kontratë edhe listën e çmimeve, pasi pa këtë element kontrata e publikuar nuk ka vlerë për palën e interesuar si dhe është obligim ligjor;

- Komuna e Kamenicës duhet që kontratat në ueb faqe t'i publikojë më shpejt pasi në disa raste kontrata veçse kishte përfunduar në kohën kur është publikuar.